



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .01.2024

Lënda: Informacion z. Q.Q.

E-mail : hotmail.com

Cel :

I nderuar z. Q.,

Në vijim të kominikimit shkresor të dërguar më parë me shkresat nr. 1775/1 prot datë 30.10.2023, dhe nr 1775/2 prot datë 18.12.2023, të përcjella në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion nr. 1775 prot datë 17.10.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të nenit 3 dhe 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet njohja dhe disponimi materialeve :

1. Kërkesat e paraqitura në institucion lidhur me kandidaturën time si Ambasador të përcjella nga ana e MEPJ dhe përgjigjet tuaja për këtë çështje;
2. Dokumentet që provojnë gjetjet, duke saktësuar institucionin prej nga janë tërhequr, datën dhe nr. e protokollit të tërheqjes, individit që i ka dorëzuar dhe ai që i ka marrë në dorëzim (kërkesë e bazuar në nenin 18 të ligjit nr. 72/2022);
3. Të gjithë praktikën që është ndjekur nga institucioni (Autoriteti) lidhur me personin tim; Ju informojmë si më poshtë:

Lidhur me pikën 1 dhe 3 të kërkesës së mësipërme informojmë:

Kërkesat e paraqitura nga MEPJ për kandidaturën si ambasador, mund të kërkoheshin që të viheshin në dispozicion që në krye të herës pranë institucionit të MEPJ, si institucioni ku **së pari** kandidon për tu emëruar në detyrën e titullarit të përfaqësive diplomatike pra ushtron detyrën funksionale dhe ku kandidati ka plotësuar dhe nënshkruar formularin e aplikimit për zyrtarët, dhe **së dyti** si institucioni që në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga neni 38 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe VKM-së nr. 816/2015, vë në lëvizje procedurën e verifikimit dhe kërkon informacion, pasi sipas ligjit nr 45/2015, Autoriteti nuk vihet në lëvizje kryesisht por vetëm me kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike si në rastin konkret.

Nisur nga kërkesat e nenit 29 të Ligjit 45/2015, vetëm në këtë rast Autoriteti ka detyrimin t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra sipas germës “f” si “drejtues të përfaqësive diplomatike”. Autoriteti publik MEPJ, e zotëron vetë shkresën me të cilën kërkon verifikimin e z. Q. e në këto kushte kërkuesi mund të kërkonte ta dispononte nga autoriteti publik ku ushtron funksionin.

Në kuadër të transparencës së veprimtarisë, informojmë se në zbatim të detyrimit ligjor nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, Institucioni Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me shkresën nr. 12414/5 prot datë 31.08.2023 (nr. 1485 prot datë 01.09.2023 tonën), ka kërkuar informacion në lidhje me 9 kandidatura të propozuara për

tu emëruar titullarë të përfaqësive diplomatike të RSh jashtë vendit sipas listës emërore ku gjendet edhe emri i z. Q.Q. duke dërguar edhe Formularët e aplikimit për zyrtarët që emërohen e ngrihen në detyrë.

Për të njëjtët zyrtarë, me shkresën nr. 3203 datë 21.07.2023 me nivel klasifikimi, Institucioni i Presidentit (si institucioni që dekreton kandidaturat) ka kërkuar verifikimin e z. Q. si një prej kandidatëve të propozuar për tu emëruar titullarë të përfaqësive diplomatike të RSh jashtë vendit. Kërkesa nuk shoqërohej nga formularët e aplikimit (këta të fundit u përcollën me shkresën nr 12414/5 prot datë 31.08.2023 nga MEPJ). Pas verifikimeve të kryera, (dokumentet arkivore të identifikuara ku rezultoi emri i z. Q., janë pasqyruar si në Vendimin nr.7 datë 12.09.2023 i Autoritetit, që me shkresë përcjellëse ju dërgua MEPJ-së dhe Vendimit nr 6. datë 12,09.2023 për Presidencën të dy vendimet me nivel klasifikimi. Të njëjta gjetje arkivore janë pasqyruar edhe në Vendimin nr 648 datë 02.11.2023 në kuadër të kërkesës individuale, gjetje me të cilat tashmë kërkuesi është njohur dhe i disponon.

Vendimi nr 7 datë 12.09.2023 dërguar MEPJ dhe shkresa përcjellëse janë deklasifikuar me Vendim datë 03.01.2024 të KDZH-së dhe mund të vihen në dispozicion kërkuarit në çdo moment.

Lidhur me kërkesën e dytë: Baza ligjore në këtë pikë të kërkesës tuaj për informacion, është vendosur bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Informacioni i kërkuar në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” konsiderohet **pjesërisht** informacion publik e në këtë kuadër, në zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, mbështetur në parimin e transparencës dhe aksesit në informacion, mund të konsultohet edhe në faqen zyrtare (lutem referohuni në link-un: <http://autoritetidosjeve.gov.al/>), në rubrikën Lista e dokumenteve që administrohen nga AIDSSH me afatet e ruajtjes gjenden Fondet arkivore të trashëguara nga Ministria e Brendshme.

Për këtë pikë të kërkesës bashkëlidhur shkresës do gjeni :

- a. një kopje të printuar të kësaj rubrike si edhe
- b. kopje të VKM **nr. 98, datë 15.02.2017**, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrim e Autoritetit, të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete e tjera publike”, akt nënligjor nxjerrë në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 45/2015 ku parashikohet se “Këshilli i Ministrave, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore për procedurën e kalimit në administrim të Autoritetit të materialeve arkivore, të parashikuar nga nenet 14 dhe 15, mënyrën e ruajtjes fizike të tyre “, ndërsa neni 44 i ligjit rendit institucionet që administrojnë në arkivat e tyre fondin e ish Sigurimit të shtetit për periudhën 1944-1991, me qëllim kalimin në administrim tek Autoriteti të të gjithë fondit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit”, sipas listës së dokumenteve të publikuar në programin e transparencës.

Nga ana tjetër Neni 18 i ligjit 45/2015 i ndryshuar së fundmi me ligjin nr 72/2022, lidhet me Arkivimin e dokumenteve nga Autoritetit dhe parashikon detyrimet për të si më poshtë:

1. “Autoriteti krijon arkivin e tij për mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve. Arkivi organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rregulloren e Autoritetit dhe legjislacionin në fuqi për arkivat.

2. Autoriteti arkivon të gjitha dokumentet, kopjet dhe dublikatat e mbledhura, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Në arkivin e tij, Autoriteti: a) dokumenton kohën, individin, institucionin apo kërkuesin, të cilëve u janë dorëzuar apo përcjellë, pas përfundimit të përpunimit, dokumente apo informacione nga dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; b) përcakton informacionet që janë futur në sistemet e përpunimit të të dhënave dhe kohën kur janë futur; c) ndalon hyrjet e paautorizuara; ç) ndalon marrjen e aksesit të personave të paautorizuar në dokumentet e ish-Sigurimit dhe sistemet e përpunimit të të dhënave, me të cilët përpunohen informacione prej dokumenteve; d) garanton se dokumentet nuk lexohen, kopjohen, ndryshohen, asgjësohen apo largohen pa autorizim; dh) garanton se transporti i dokumenteve shoqërohet nga të paktën dy anëtarë të Autoritetit, apo persona të autorizuar nga Autoriteti; e) parashikon modele organizimi të tilla, që t'u përgjigjen kërkesave specifike për ruajtjen e të dhënave”.

Sa më sipër, Neni 18 i ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, lidhet me organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit të Autoritetit në lidhje me mënyrën dhe kriteret e arkivimit e dokumenteve, përdorimin, shfrytëzimin, ruajtjen, dhe përpunimin e fondit arkivor në institucion, në funksion të garantimit të së drejtës për informim sipas dispozitave të ligjit nr 45/2015 i ndryshuar, ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” dhe Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor të Republikës së Shqipërisë”.

Pra nga shqyrtimi i kërkesës që bazohet në nenin 18 të ligjit nr. 45/2015, vërehet se aksesimi në dokumentacionin i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, dhe jo dispozitave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Ligji nr. 45/2015, normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posaçëm, dhe gjen zbatim në këtë pikë duke preluar mbi ligjin nr. 119/2014, i cili zbatohet për atë që është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi **informacioni dhe dokumentacioni që kërkohet për vënie në dispozicion lidhet me vënien në dispozicion të të dhënave të fondit arkivor, dhe jo me informacion publik.**

Në përfundim vlerësojmë gjithashtu se në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se nga ana e Autoritetit publik është refuzuar dhënia e informacionit kërkuesit. Kjo provohet edhe nga fakti se institucionet janë angazhuar dhe kanë bashkëpunuar për respektimin e procedurës sipas pikës 4 të nenit 6 të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” dhe nenit 17 pika 5 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, kërkuesi është informuar rregullisht me shkresën e parë nr 1775/1 prot datë 30.10.2023, për afatin kohor ligjor të nevojshëm për procedurën e rishikimit të klasifikimit, dhe me shkresën e dytë nr. 1775/2 prot datë 18.12.2023, për faktin që nevojitet kohë sepse procedura nuk ka përfunduar ende nga strukturat.

Vlen të theksohet edhe fakti se ndërkohë që trajtohej kërkesa për informacion dhe dokumentacion e paraqitur sipas ligjit nr 119/2014, nga Autoriteti u trajtua me shumë përparësi brenda një kohe të shkurtër edhe kërkesa individuale e paraqitur në Autoritet nga vetë kërkuesi për vënie në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit arkivor ku gjendet emri i tij, pas marrjes dijeni pranë institucionit të Presidentit për pezullimin e procedurës së kandidimit ‘për shkak të shkresës së përcjellë nga Autoriteti sipas të cilës, figuron në dokumentet e ish- Sigurimit gjatë periudhës 1986-1991”. Vendimi nr 648 datë 02.11.2023 dhe materiali prej 67 faqesh është në dispozicion të kërkuesit.

Sa më sipër mund të paraqiteni në cdo kohë pranë Autoritetit për vënien në dispozicion të akteve:

1. Shkresa nr. 12414/5 prot datë 31.08.2023 e MEPJ-së.
2. Vendimi nr. 7 datë 12.09.2023 drejtuar MEPJ i deklasifikuar me Vendim datë 03.01.2024 të KDZH-së.
3. Shkresa përcjellëse nr ____ prot datë 03.01.2024 drejtuar MEPJ, e deklasifikuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti

Programi i Transparencës së Autoritetit

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

Lista e dokumenteve që administrohen nga AIDSSH me afatet e ruajtjes

Fonde arkivore të trashëguara nga Ministria e Brendshme

I. Drejtoria e parë e Sigurimit të Shtetit:

1. Numri i Fondit: 4
2. Kufijtë kohorë: 1944-1991
3. Sasia e dosjeve: 8488
4. Mjetet e informimit: Inventari i dosjeve
5. Mënyra e ruajtjes: dokumente origjinale dhe mikrofilm
6. Gjuha: shqip
7. Niveli i klasifikimit: Sekret, Tepër sekret
8. Deklasifikimi (vendimi i KDZH, shënohet kur ndryshon statusi)

Në këtë fond arkivor përfshihen dokumente që pasqyrojnë veprimtarinë e ish Drejtorisë së Parë të Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës 1944-1991 duke përfshirë udhëzime, qarkore, korespondenca të ndryshme dërguar seksioneve apo degëve në lidhje me çështjet që mbulonte kjo drejtori, analiza vjetore, plane masash, përgjithësime, informacione, letra, raporte, informacione etj. Përgjithësisht dokumentet që i përkasin këtij fondi janë të klasifikuara.

II. Drejtoria e dytë e Sigurimit të Shtetit:

1. Numri i Fondit: 134
2. Kufijtë kohorë: 1955-1991
3. Sasia e dosjeve: 859
4. Mjetet e informimit: Inventari i dosjeve
5. Mënyra e ruajtjes: dokumente origjinale dhe mikrofilm
6. Gjuha e përdorur: shqip
7. Niveli i klasifikimit: Sekret, Tepër sekret
8. Deklasifikimi (vendimi i KDZH, shënohet kur ndryshon statusi)

Në këtë fond arkivor përfshihen dokumente që pasqyrojnë veprimtarinë e ish Drejtorisë së Dytë të Sigurimit të Shtetit. Kjo drejtori ka qenë një prej tre drejtorive të ish Sigurimit të Shtetit. Deri në vitin 1962 ka qenë në nivel dege brenda Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit. Në vitet 1962 – 1966 njihet si Drejtoria e Tretë e Sigurimit të Shtetit. Në vitet 1966 – 1991 ka qenë Drejtoria e Dytë e Sigurimit të Shtetit dhe në fund, në vitet 1991 – 1992 njihet me emrin Drejtoria e Ruajtjes së Personaliteteve.

III Drejtoria e tretë e Sigurimit të Shtetit (zbulimi politik)

1. Numri i Fondit: 6
2. Kufijtë kohorë: 1945-1975
3. Sasia e dosjeve: 997
4. Mjetet e informimit: Inventari i dosjeve
5. Mënyra e ruajtjes: dokumente origjinale dhe mikrofilm
6. Gjuha e përdorur: shqip
7. Niveli i klasifikimit: Sekret, Tepër sekret
8. Deklasifikimi (vendimi i KDZH, shënohet kur ndryshon statusi)

Në këtë fond arkivor përfshihen dokumente që pasqyrojnë veprimtarinë e ish Drejtorisë së Tretë të Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës 1945-1975. Fondi përmban dokumente administrative si raporte, relacione, letra, radiograma, etj mbi veprimtarinë agjenturore që zhvillohet kundër vendit tonë jashtë kufinjve si dhe probleme të tjera objekt zbulimi.

IV. Dosje hetimore - gjyqësore

1. Numri i Fondit: 1
2. Kufijtë kohorë: 1945-1991
3. Sasia e dosjeve: 13968
4. Mjetet e informimit: Inventar i dosjeve
5. Mënyra e ruajtjes: dokumente origjinale dhe mikrofilm
6. Gjuha e përdorur: shqip

Ky fond arkivor përmban dosje të hetimit dhe gjykimit të shtetasve të ndryshëm të cilët janë akuzuar veprat “armik i popullit”, “agjitacion dhe propagandë”, “tradhti ndaj atdheut”, “spiunazh”, etj.

V E N D I M

P Ë R

PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË KALIMIT NËN ADMINISTRIMIN E AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT TË MATERIALEVE ARKIVORE TË ISH-SIGURIMIT TË SHETIT, QË GJENDEN NË MINISTRINË E MBROJTJES, MINISTRINË E PUNËVVE TË BRENDSHME, SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT DHE NË AUTORITETET E TJERA PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15 e 43, pika 1, të ligjit nr.45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) dhe autoritetet e tjera publike t'i dorëzojnë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në vazhdim "Autoriteti", të gjithë materialin arkivor të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga data 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, pavarësisht nga data e grumbullimit të këtyre dokumenteve në arkiv. Në këtë dokumentacion përfshihen:

a) të gjitha mjetet bartëse të informacioneve, të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të disponuara prej tij apo që i janë vënë në përdorim, pavarësisht nga forma e ruajtjes, që mund të jenë dosje, të dhëna, shkresa, harta, plane, filma, regjistrime me figurë, me zë dhe regjistrime të tjera;

b) riprodhimet, kopjimet e tyre dhe publikata të tjera, të cilat janë fotokopjuar dhe administruar në bazë të akteve ligjore e nënligjore;

c) mjetet ndihmëse të domosdoshme për të bërë interpretime, veçanërisht programet për përpunimin automatik të të dhënave;

ç) dokumentacioni shoqërues, procesverbalet, aktet e dorëzimit dhe aktet e marrjes në dorëzim të këtij dokumentacioni që prej datës së krijimit të tyre;

d) raportet e detajuara për të gjitha lëvizjet, ndryshimet, rigrupimet, dëmtimet dhe humbjet që ka pësuar fondi i dosjeve të ish-bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit si edhe dokumentacioni tjetër i sipërpërmendur, prej datës 2 korrik 1991 e në vijim;

dh) konstatimet, informacionet, urdhrat dhe raportet e hartuara, që kanë lidhje me menaxhimin, sistemimin, inventarin dhe gjendjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që janë grumbulluar në arkivin e institucioneve prej krijimit të tyre;

e) çdo informacion mbi procesverbalet e inventarizimit dhe regjistrat e të gjitha llojeve që i përkasin periudhës së sipërpërmendur si dhe çdo e dhënë tjetër që do t'i shërbejë punës së Autoritetit.

2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit vendosin pa afat në dispozicion të Autoritetit mjediset e çdo infrastrukturë tjetër të arkivave, ku janë të magazinuara dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe punonjësit e këtyre arkivave. Nëse në të njëjtin mjedis disponohen edhe dokumente të tjera të klasifikuara, atëherë institucioni vë në dispozicion një mjedis tjetër të përshtatshëm për shfrytëzimin e këtij dokumentacioni. Ky afat përfundon me transferimin e plotë të dokumenteve arkivore në arkivin e Autoritetit.

3. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 miratojnë listat e punonjësve të pajisur me certifikatë sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, të propozuar nga Autoriteti për të hyrë në mjediset arkivore të këtyre institucioneve.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit ia kalojnë Autoritetit përgjegjësinë e dhënies së informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përfshirë edhe lëshimin e vërtetimeve në përgjigje të kërkesave të subjekteve fizike dhe juridike, publike dhe private, që lidhen me këto dokumente.

5. Autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit i krijojnë menjëherë mundësitë dhe kushtet e punës Autoritetit, që, në bashkëpunim me strukturat e tyre përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, ky Autoritet të fillojë sa më shpejt të japë përgjigje ndaj kërkesave për informim të institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera, të parashikuara në ligj.

6. Autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të përcaktojnë një program të përbashkët pune për kalimin e materialit arkivor, duke respektuar afatet e përcaktuara në ligj.

7. Punonjësit dhe personat përgjegjës, që ushtrojnë detyrën për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, në arkivat e autoritetit publik, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë

së Mbrojtjes e Shërbimit Informativ të Shtetit, gjatë procedurës së kalimit të këtij dokumentacioni arkivor nën administrimin e Autoritetit, do të jenë pjesë e grupeve të punës që do të bashkëpunojnë me Autoritetin për të përmbushur detyrat e tij ligjore.

8. Grupet e punës drejtohen nga Autoriteti. Pagesa e anëtarëve të grupeve të punës kryhet nga institucioni ku ata bëjnë pjesë.

9. Punonjësit e përmendur në pikën 7, të këtij vendimi, me kërkesë të tyre dhe me miratimin e institucionit pranë të cilit ushtrojnë detyrat, mund të transferohen pranë Drejtorisë së Arkivit të Autoritetit. Për nëpunësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, që do të transferohen pranë Autoritetit, të zbatohen dispozitat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

10. Brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe autoritetet e tjera publike të dërgojnë pranë Autoritetit emrat e personave, të cilët do të jenë pjesë e grupeve të punës.

11. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, autoritetet publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit duhet të kenë kaluar në administrim të Autoritetit të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe çdo autoritet publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A